



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

LËNDA: GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KODI: 4.1

PROGRAMI I LËNDËS GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI PËR KLASËN E 10

TIRANË, NËNTOR 2008

Programi i lëndës “Gjuhë shqipe dhe letërsi” është ndërtuar duke marrë parasysh rolin e gjuhës dhe të letërsisë në jetën e njeriut. Ai mbështetet në parimin që gjuha dhe letërsia përbëjnë themelet në procesin e të mësuarit, komunikimit, formimit të identitetit personal e kulturor, si dhe të lidhjeve ndërnjerëzore.

Programi i gjuhës shqipe dhe letërsisë është ndërtuar mbi bazën e parimit të integritit të gjuhës shqipe dhe letërsisë, si dhe parimit të rimarrjes së njohurive, duke i zgjeruar dhe thelluar ato.

E konceptuar si një lëndë e integruar, ajo do të studiojë artin e të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit.

Lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë është ndërtuar në mënyrë të tillë që të zhvillojë:

- a) të kuptuarit, ku nxënësi duhet të zbulojë, të interpretojë, të analizojë, të nxjerrë përfundime, të sintetizojë dhe të vlerësojë;
- a) të krijuarit, ku nxënësi duhet të kërkojë, të planifikojë, të draftojë, të ridraftojë, të redaktojë,

duke trajtuar të gjitha format e produkteve (teksteve) gjuhësore të tilla, si:

- tekste të gjuhës së shkruar,
- tekste të gjuhës së folur,
- tekste të gjuhës vizuale.

Koncepti i të modeluarit është mjaft i rëndësishëm. Kjo do të thotë që gjatë të kuptuarit, nxënësi do të shohë sesi gjuha ndërton, formon, modelon eksperiencë nëpërmjet stilit, gjinive dhe kontekstit dhe gjatë të krijuarit, nxënësit do t’i jepen mundësi që nëpërmjet gjuhës të krijojë përvojën e vet. **Integrimi i të kuptuarit dhe i të krijuarit është i domosdoshëm gjatë të mësuarit të gjuhës shqipe dhe letërsisë.**

Parimi i integritit të gjuhës shqipe dhe letërsisë qëndron në bazë të kësaj lënde.

Lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë e trajton gjuhën në pesë llojet e përdorimit të saj: tregimtar, shpjegues, përshkruues, bindës/argumentues dhe informativ, të cilat mund të përdoren më “vete” brenda llojit të tekstit, por mund të përzihen me njëri-tjetrin në tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme. Kështu, mund të kemi tekste ku paraqitet një argument estetik, një përshkrim bindës ose një lojë (teatër) informative.

Nxënësi duhet ta shikojë veprimtarinë e të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të vështruarit si aftësi interpretative dhe aktivitet krijues, të cilat duhet të realizohen domosdoshmërisht brenda orës së mësimi.

Përmes përdorimit të gjuhës së saktë dhe të përshtatshme, nxënësi vetë mund të realizojë një ndjenjë të veçantë personale dhe të zbulojë sesi gjuha mund të punojë për të në lidhje me domethënien, të menduarit dhe komunikimin efektiv.

Gjuha shqipe dhe letërsia do të orientojë nxënësit drejt përvetësimit aktiv të informacionit, procesit kritik dhe interpretimit të informacionit nëpërmjet:

- a. **Koncepteve dhe procesit**, si aftësi për të menduar, për të dalluar, për të arsytuar dhe për të vlerësuar në një shumëllojshmëri të konteksteve gjuhësore, personale, sociale, profesionale dhe kulturore;

- b. Njohurive dhe përmbajtjes,** si njohuri rreth natyrës dhe përdorimit të gjuhës; shumëllojshmërisë së funksioneve dhe zhanreve në të cilat ajo operon. Në këtë kontekst, tekstet letrare dhe joletrare që do të përdoren duhet të jenë nga më të rëndësishmet si në korpusin e letërsisë shqiptare dhe asaj botërore.
- c. Aftësive,** si të *interpretuarit* dhe të ndërtuarit (krijuarit) të veçorive të tekstit (gramatikë, shqiptim, paragraf...) të gjuhës së shkruar dhe të folur për t'u shprehur dhe komunikuar.
- d. Qëndrimeve dhe efekteve,** si:
 - zhvillimi i interesit dhe kënaqësia në përdorimin e gjuhës;
 - respekti për potencialin e gjuhës për të krijuar kuptimin;
 - vlerësimi për manifestimet (shfaqjet) e veta të ndryshme kulturore.

Synimet e përcaktuara janë plotësisht të ndërvarura. Kështu, nxënësi nuk mund të mësojë koncepte, të marrë njohuri të zhvillojë aftësi dhe të realizojë procese pa i ndeshur e prekur në një gjuhë të përshtatshme dhe kuptimplotë, të përdorur në tekste të llojeve të ndryshme. Nxënësi nuk e *respekton* gjuhën, nëse nuk e ndien kontributin e saj në të kuptuarit e botës. Në përpjekje të arritjes së këtyre objektivave është jetësore (e domosdoshme) që nxënësit t'i paraqiten tekste a vepra, të cilat krijojnë një kontekst kuptimplotë dhe e ftojnë në dialog dhe ndërveprim. Ky ndërveprim nxit inkurajimin e nxënësit në përvetësimin në mënyrë kritike të teksteve të ndryshme.

Teksti është elementi i domosdoshëm dhe më i rëndësishëm i lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë, pasi nëpërmjet tij do të realizohen të gjitha objektivat e programit.

Aftësimi i të lexuarit të rrjedhshëm dhe të shkruarit të përshtatshëm është një veçori e rëndësishme e lëndës. Nxënësi duhet të lexojë tekste të llojeve të ndryshme në mënyrë që të aftësohet si lexues dhe të përfitojë kënaqësi nga të lexuarit. Eksperiencat e tij me tekstin duhet të jenë të gjera, duke filluar që nga tekstet poetike e deri tek tekstet joletrare. Të lexuarit dhe të shkruarit ofrojnë fuqinë për të informuar, për të përcjellë dije, si dhe për të krijuar një lloj ure midis kohës dhe vendndodhjes. Për shembull, interpretimi dhe krijimi i teksteve letrare e ndihmon nxënësin të kuptojë brezat paraardhëse, si dhe të marrë pjesë e të kontribuojë në ndërtimin dhe përcjelljen e trashëgimisë kulturore.

Në përzgjedhjen e teksteve letrare dhe joletrare, autorët e teksteve duhet të mundësojnë ndërlidhjen midis kësaj lënde dhe lëndëve të tjera të kurrikulës, si: historia, shkencat sociale, matematika, shkencat natyrore etj. Duke kuptuar dhe ndërtuar tekstet letrare dhe joletrare, nxënësi zbulon ndërlidhjet midis tyre.

Aftësimi i të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit përbëjnë një veçori tjetër të kësaj lënde. Aftësia për të shprehur idetë jo vetëm me shkrim, por edhe me gojë në mënyrë të organizuar, është një pjesë shumë e rëndësishme e këtij programi. Po ashtu, zbulimi, interpretimi, analiza dhe vlerësimi i argumenteve të tjerëve nëpërmjet të dëgjuarit dhe të vështruarit është proces kyç i të reflektuarit. Nxënësi duhet të shprehë opinionin e tij dhe të angazhohet në procesin e të reflektuarit dhe të arsyetuarit.

Zhvillimi i aftësisë dalluese dhe interpretative të nxënësit në lidhje me media të ndryshme, si dhe inkurajimi për të paraqitur produkte krijuese do të jenë elemente të rëndësishme të lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë.

Në përfundim, Gjuha shqipe dhe letërsia do të përcjellë tek nxënësi një sistem dijesh koherente, të përgjithësuara e bashkëkohore, të cilat mundësojnë njohjen, përdorimin dhe mbajtjen e qëndrimit ndaj pasurisë së gjuhës shqipe dhe shprehjes së saj në tekste dhe vepra nga më përfaqësueset në kulturën shqiptare dhe më gjerë.

Zhvillimi i interesit të nxënësit për gjuhën dhe letërsinë si të tilla, lidhja ndërmjet tyre, dialogimi, kuptimi e vlerësimi kritik i vlerave të letërsisë dhe llojeve të tjera të produkteve gjuhësore janë boshte kryesore të kësaj lënde.

1. SYNIMI I LËNDËS

Lënda ka për synim të zhvillojë tek nxënësit:

- të lexuarit dhe të shkruarit e logjikshëm dhe kritik për t'i përgatitur ata për të ndërmarrë sfida dhe përgjegjësi gjatë jetës në të gjitha kontekstet;
- respektin dhe vlerësimin për përdorimin e gjuhës së shkruar dhe të folur në mënyrë të saktë dhe të përshtatshme;
- vetëdijen për vlerat e teksteve letrare dhe joletrare për të pasuruar perceptimet, për të rritur sensin e identitetit kulturor dhe për të krijuar përvoja për kënaqësi estetike.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të gjimnazit, në lëndën e gjuhës shqipe dhe letërsisë, nxënësit duhet:

- të përforcojnë njohuritë e tyre për gjuhën, letërsinë dhe komunikimin, duke përdorur koncepte të përshtatshme;
- të zhvillojnë mendimin kritik nëpërmjet mundësive të përditshme për të lexuar, për të shkruar, për të folur, për të vështruar dhe për të dëgjuar tekste të formave të ndryshme letrare, joletrare e mediatike;
- të respektojnë natyrën rekursive (përsëritëse) të artit, të përdorimit të gjuhës në jetën e përditshme, për qëllime dhe audiencë të larmishme;
- të familjarizohen me konceptet kryesore të letërsisë, për të vlerësuar domethënien e teksteve duke u nisur nga kultura e tyre, me qëllim ndërtimin e identitetit dhe të kulturës individuale;
- të njihen me vepra të shkrimtarëve përfaqësues të periudhave të ndryshme të letërsisë shqiptare dhe të huaj;

- të zhvillojnë të menduarit kritik, duke zgjeruar njohuritë e përgjithshme në letërsi, si dhe mprehtësinë artistike e imagjinative për të ndërtuar imazhin e tyre për botën;
- të përvetësojnë aftësi analitike për të analizuar, për të interpretuar, për të vlerësuar dhe për të prodhuar tekstet e tyre për një larmi funksionesh;
- të zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit për t'u bërë lexues të pavarur e të rrjedhshëm, si dhe për të kuptuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme;
- të shkruajnë me një përqendrim të qartë, organizim koherent, me të dhëna dhe hollësi të mjaftueshme për një sërë audiencash, qëllimesh dhe kontekstesh;
- të pasurojnë shprehitë folëse, shkruese, lexuese në përshtatje me objektin e ligjërit;
- të flasin në mënyre efektive për audiencë, qëllime, situata dhe kontekste të ndryshme;
- të jenë dëgjues aktivë në grupe formale dhe joformale, për të marrë informacion nga një shumëllojshmëri burimesh në situata të ndryshme;
- të vështrojnë, të vlerësojnë dhe të reagojnë ndaj teksteve dhe burimeve të shkruara, jo të shkruara dhe elektronike-
- të interpretojnë informacione të ndryshme për botën në përgjithësi.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

36 javë x 3 orë = 108 orë

TË LEXUARIT

Linja: Ndërgjegjësimi fonologjik

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e njohurive fonologjike të domosdoshme për të lexuar saktë fjalën. Ai/ajo i përdori këto njohuri gjatë procesit të të lexuarit të teksteve të ndryshme¹, për të shqiptuar saktë fjalën dhe për ta kuptuar atë.

Linja	Objektiva
Ndërgjegjësimi fonologjik²	Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja : <ul style="list-style-type: none">- të respektojnë strukturën fonetike të fjalës;- të artikulojnë fjalët e tekstit të dhënë në përputhje me njohuritë e fonetikës për strukturën fonetike të fjalës (p.sh.: rastet e takimit të dy bashkëtingëlloreve që në pamje të parë krijojnë një shkronjë të përbërë etj.);- të dallojnë se të gjitha anët tingullore të shqipes, si p.sh.: shqiptimi letrar, theksi, intonacioni, organizimet tingullore, imitimet dhe simbolizmi tingullor mund të përdoren për shprehësi.

Linja: Njohuritë mbi fjalën

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e koncepteve mbi fjalën. Ai/ajo zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, si dhe nëpërmjet procesit të analizës fjalëformuese; gjen parashtesat dhe prapashtesat e huaja që u janë bashkangjitur fjalëve të shqipes, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti. Për të realizuar procesin e analizës strukturore, nxënës/i,-ja përdori tekste të marra nga burime të ndryshme.

Linja	Objektiva
Njohuritë mbi fjalën	Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja : <ul style="list-style-type: none">- të hetojë origjinën e fjalëve si një mjet për të kuptuar fjalën;- të dallojnë fjalët me prejardhje të huaja;- të zbulojë kuptimin e fjalës nëpërmjet analizës fjalëformuese;

¹ Tekste të ndryshme nënkuptojnë tekste letrare dhe joletrare, të shkruara, të folura dhe pamore.

² Objektivat e kësaj linje janë kërkesa të përhershme, për të realizuar drejtshqiptimin e shqipes standarde.

	<ul style="list-style-type: none"> - të dallojë parashtesat dhe prapashtesat me origjinë të huaj; - të dallojë përdorimet e fjalëve të huaja si burime shprehësie; - të dallojë kuptimet e dyta të fjalëve si pasuri gjuhësore e shqipes brenda kontekstit; - të dallojë kuptimet e figurshme të fjalëve si pasuri e shprehjes artistike në një tekst letrar; - të interpretojë kuptimet e dyta dhe të figurshme të fjalëve; - të analizojë kuptimet e dyta e të figurshme të fjalëve, si dhe ngjyresat emocionale të tyre.

Linja: Rrjedhshmëria

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja zhvillon të kuptuarit e konceptit për ritmin, rrjedhshmërinë (shpejtësi, saktësi, shprehësi dhe kuptimësi) dhe shqiptimin e fjalëve në tekste të ndryshme. Ai/ajo ushtrohet në të lexuarit rrjedhshëm dhe në mënyrë të kuptimshme të teksteve të ndryshme, të marra nga burime të ndryshme.

Linja	Objektiva
Rrjedhshmëria	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të lexojë rrjedhshëm (me shpejtësi, saktësi, shprehësi, kuptimësi) dhe me shqiptimin e duhur tekste të ndryshme; - të respektojë ritmin në tekstet poetike; - të respektojë logjikën e leximit të një teksti tregimtar; - të respektojë kërkesat për leximin e një teksti dramatik.

Linja: Strategjitë e të lexuarit

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e koncepteve dhe të njohurive për strategjitë e të lexuarit. Ai/ajo përdori strategjitë e të lexuarit, bën identifikimin e veçorive të teksteve, përdori organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit. Nxënës/i,-ja parafrazon dhe përmbledh tekstet e punuara.

Linja	Objektiva
Strategjitë e të lexuarit	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojë të veçantën e një teksti letrar përmes gjuhës së figurshme me të cilën ai shprehet; - të zbulojë vlerat artistike të një vepre letrare përmes

	<p>leximit të thelluar të veprës së plotë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zbatojë strategji të të lexuarit të tilla, si: strategjia e brainstorm-it , e hartës së tekstit, e problemzgjdhjes, e organizuesit grafik, e përmbledhjes, diagrami i Venit, mendo/puno në dyshe/shkëmbe me të tjerët, e parashikimit që janë efektive për të kuptuar tekste të ndryshme; - të identifikojë karakteristika strukturore të teksteve letrare dhe joletrare: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti, evidenca, indeksi, fjalorthi, tabela e përmbajtjes; - të identifikojë karakteristika të teksteve letrare nga ana kompozicionale (i jashtëm, i brendshëm), elemente të subjektit (ekspozicioni, pika e lidhjes, zhvillimi i veprimit, pika kulminante, zgjidhja), prologu, epilogu; - të identifikojë karakteristika të teksteve nga ana përmbajtësore (tema, tematika, motivi, karakteret); - të identifikojë metrin (llojin e vargut, rrokjet, strofën) në tekste poetike; - të përdorë tabela, diagrame, harta etj. për të memorizuar informacionin dhe për të monitoruar procesin e të kuptuarit; - të përdorë njohuritë e mëparshme, përmbajtjen dhe veçoritë organizative e grafike të teksteve të ndryshme për të bërë parashikime, për t'i rishikuar dhe për t'i verifikuar ato, gjatë dhe pas leximit të tyre; - të analizojë elementet formale të një teksti dramatik: dialog, monolog, didaskali; - të bëjë pyetje analitike, sintetizuese e vlerësuese përpara, përgjatë dhe pas leximit të tekstit; - t'u përgjigjet pyetjeve analitike, sintetizuese e vlerësuese në mënyrë logjike përpara, përgjatë dhe pas leximit të tekstit; - të përdorë informacionin e tekstit për të zbuluar nëntekstin dhe për të nxjerrë përfundime; - të dallojë informacionin thelbësor nga ai jothelbësor; - të përdorë parafrazimin dhe aftësitë organizuese për të parafrazuar informacionin e marrë nga tekste të llojeve të ndryshme, në një linjë të logjikshme duke ruajtur qëllimin e autorit/autore; - të bëjë përmbledhjen e një teksti; - të zbulojë elemente të stilit të autorit në një vepër letrare; - të analizojë stilin e autorit/autore në tekste të ndryshme; - të zbulojë arsyet pse u është caktuar një tekst për t'u lexuar; - të ndjekë udhëzimet e paraqitura për qëllime të ndryshme në tekstet informative; - të identifikojë qëndrimin e autorit/autore në një tekst
--	--

	bindës; - të zbulojë funksionet e komunikimit në tekste të ndryshme; - të përshkruajë teknikat që autori/autorja përdor për të mbështetur pozicionin e tij/e saj; - të krahasojë dy tekste, që janë të së njëjtës gjini, që kanë të njëjtën formë ligjërimi dhe trajtojnë të njëjtat tema, për të treguar sesi autorët nxjerrin përfundime të njëjta ose të ndryshme.
--	--

Linja: Pasurimi i fjalorit

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja përdor materiale udhëzuese dhe hulumton fjalët e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin.

Linja	Objektiva
Pasurimi i fjalorit	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë materiale udhëzuese (p.sh.: fjalorë, enciklopedi, internet etj.), që janë të përshtatshme për të pasuruar fjalorin në fusha të ndryshme; - të hulumtojë fjalët e shkrimeve letrare dhe joletrare për të pasuruar fjalorin; - të përdorë njohuritë e origjinës së fjalëve si dhe të dhënat e kontekstit historik e letrar, për të përcaktuar kuptimin e fjalëve të fushave të caktuara të dijes; - të përdorë dukuri të tilla gjuhësore, si: polisemia, homonimia, onomatopetë, shprehjet frazeologjike, fjalëshpejtat (kalamburet), sinonimia, antonimia për të rritur forcën shprehëse të mendimit të tij/të saj; - të dallojë figurshmërinë e përdorur në një tekst letrar përmes burimeve gjuhësore të shprehësisë (fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikologjike), për të pasuruar fjalorin; - të hulumtojë fjalët e shkrimeve letrare dhe joletrare për të pasuruar fjalorin; - të ndërtojë fjalorin e një teksti letrar, duke përdorur modele fjalorësh të fushave të ndryshme studimi;

Linja: Aftësitë e të kuptuarit të tekstit dhe reflektimi ndaj tij

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja zhvillon njohuritë dhe aftësitë për të kuptuar tekstin. Ai/ajo analizon tema të ndryshme duke zbuluar gjuhën e figurshme të tekstit; identifikon faktin, opinionin, premiset e një argumenti. Për të zhvilluar aftësitë e të kuptuarit të tekstit, nxënës/i,-ja përdor tekste të marra nga burime të llojeve të ndryshme.

Linja	Objektiva
Aftësitë e të kuptuarit të tekstit dhe reflektimi ndaj tij	<p>Në përfundim të klasës së 10^{te} nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë tekstin si formë e ligjërimit: poetik, tregimtar, dramatik, eseistik; - të analizojë sesi teksti i një periudhe kohore të caktuar reflekton kushtet dhe ngjarjet historiko-shoqërore të kohës; - të gjejë tipare të përbashkëta dhe dalluese midis një teksti të traditës letrare dhe një shkrimi bashkëkohor, duke i vendosur në marrëdhënie krahasimi; - të identifikojë koncepte letrare dhe efektet e tyre në domethënien e tekstit; - të identifikojë metrin (llojin e vargut, rrokjet, skemën ritmike, strofën, rimën) në tekste poetike; - të tregojë sesi mjetet letrare ndikojnë tek emocionet dhe perceptimi i mesazhit autorial, në tekste të gjinive të ndryshme; - të analizojë gjuhën e figurshme të një teksti; - të zbulojë funksionin artistik të gjuhës së figurshme, të përdorur brenda një teksti; - të analizojë konflikte të natyrave të ndryshme në tekste të ndryshme; - të analizojë përdorimin e referencave të besueshme; - të identifikojë premisat e një argumenti; - të dallojë faktin nga opinioni duke përdorur informacione nga teksti, argumente koherente dhe këndvështrimin vetjak; - të dallojë karakterin objektiv dhe jo personal të një teksti informues, përmes përzgjedhjes së fjalëve dhe të fjalive; - të dallojë karakterin gjithëpërfshirës personal të një teksti bindës, përmes përzgjedhjes së fjalëve dhe të fjalive; - të dallojë koherencën e argumenteve në tekste kritike; - të bëjë dallimin ndërmjet përmbledhjes së tekstit dhe qëndrimit kritik ndaj tij; - të zërthejë shprehësinë gjuhësore dhe letrare të tekstit; - të nxjerrë përfundime me shkrim dhe me gojë, bazuar në të dhënat e marra nga tekste a vepra të ndryshme të punuara në klasë. - të transmetojë njohuri, duke përdorur skemën e komunikimit letrar: autor-vepër-lexues.

Linja: Kërkimi

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja zhvillon aftësitë e domosdoshme për të realizuar punën kërkimore. Ai/ajo përzgjedh informacione për qëllime të ndryshme, vlerëson informacionin e përzgjedhur nga të tjerët, përmbledh materiale të ndryshme, si dhe nxjerr

përfundime. Për të realizuar kërkimin, nxënës/i,-ja përdor informacione të marra vetëm nga tekste të punuara në klasë gjatë vitit shkollor.

Linja	Objektiva
Kërkimi	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë cilësinë e informacionit të përzgjedhur nga autori/autorja e tekstit; - të krijojë materiale për një portofol (dosje) që tregon një drejtim të caktuar karriere; - të vlerësojë logjikën dhe vlefshmërinë e argumenteve në dokumente publike; - të paraqesë punë me shkrim dhe me gojë, të cilat përmbledhin materiale të ndryshme të punuara në klasë.

TË SHKRUARIT

Linja: Shkrimi si proces

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e procesit të shkrimit. Ai/ajo realizoi hapat e përcaktuara dhe të domodoshme për këtë proces. Nxënës/i,-ja përdori strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij/saj, redaktonte shkrimin duke përdorur sistemin e vlerësimit dhe mendimet e të tjerëve. Procesi i të shkruarit realizohet në shkrime të llojeve të ndryshme.

Linja	Objektiva
Shkrimi si proces	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të të shkruarit (parashkrimi, draftimi, rishikimi, shkrimi, dorëzimi), duke shkruar përditë e për një kohë të gjatë; - të përcaktojë temën për të cilën shkruan; - të përdorë strategji të larmishme (brainstorm-i, shkrimi i lirë, kllasteri, diagrami i Venit,) për të planifikuar shkrimin e tij/saj; - të redaktojë shkrimin duke përmirësuar stilin, këndvështrimin, organizimin, koherencën (rrjedhën logjike) dhe qartësinë e mendimit; - të përdorë elementet e sistemit të vlerësimit (ideja kryesore, nënidetë, organizimi, drejtshkrimi, pikësimi, fjalori, saktësia gramatikore, referencat) për shkrimin e tij/ e saj dhe të të tjerëve; - të përdorë (të shfrytëzojë) mendimet dhe sugjerimet e të tjerëve për të redaktuar përmbajtjen dhe organizimin e pjesës së shkruar.

Linja: Shkrimi si produkt

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e konceptit të shkrimit përfundimtar si produkt që lexohet nga një audiencë e gjerë. Ai/ajo përdori elementet e domosdoshme për të përfunduar një shkrim cilësor. Nxënës/i,-ja drafton (skicon/harton) ide, shkruan paragrafë, hyrje dhe mbyllje duke përdorur stil vetjak dhe duke zbatuar kriteret gramatikore e drejtshkrimore për një produkt cilësor. Për të realizuar këto, nxënës/i,-ja ushtrohet në veprimtari praktike dhe paraqet produkte të shkrimeve të ndryshme.

Linja	Objektiva
Shkrimi si produkt	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none">- të përdorë në shkrimet e veta karakteristikat, tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme;- të draftojë (skicojë/hartojë) një ide kryesore duke e mbrojtur atë me nënide dhe organizim cilësor;- të shkruajë pjesë me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore;- të parashikojë nevojat dhe qëndrimin e lexuesit përmes strategjive të tilla, si: gjuha e përshtatshme, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj;- të shkruajë hyrje dhe mbyllje tërheqëse e koherente;- të përdorë grafikë të përshtatshëm për të mbështetur idenë kryesore;- të shkruajë fjali të thjeshta dhe të përbëra për të shprehur mendime të caktuara;- të përdorë gjuhë të saktë, detaje specifike, përshkrime, shembuj;- të shkruajë pjesën në mënyrë të tillë që të bindë lexues të ndryshëm;- të përdorë stil vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës;- të përdorë stil vetjak për kënaqësi estetike;- të përdorë pjesë të ndryshme të ligjëratës, të cilat krijojnë imazhe të gjalla në mendjen e lexuesit;- të përdorë rrallë, por në mënyrë efektive, klishe dhe zhargonet;- të përdorë struktura të tilla, si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj., të cilat ndihmojnë lexuesin përgjatë shkrimit;- të përdorë drejt lidhëzat dhe fjalët lidhëse për të lidhur fjalitë dhe paragrafët.

Linja: Format e shkrimit, audienca dhe qëllimet

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë për të shkruar në forma të ndryshme, për një shumëllojshmëri audiencash dhe qëllimesh. Ai/ajo shkruan tekste të ndryshme, si dhe bën shkrime për nevoja vetjake, duke zbatuar kriteret e domosdoshme për secilin lloj (formë).

Linja	Objektiva
Format e shkrimit, audienca dhe qëllimet	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none">- të shkruajë tekste përshkuese për qëllime dhe audienca të ndryshme;- të shkruajë tekste shpjeguese për qëllime dhe audienca të ndryshme;- të shkruajë tekste bindëse /argumentuese për qëllime dhe audienca të ndryshme;- të shkruajë tekste informative (aplikime për shkollë, letër zyrtare) për qëllime dhe audienca të ndryshme;- të shkruajë parafrazime të teksteve për qëllime dhe audienca të ndryshme;- të shkruajë përmbledhje të teksteve të ndryshme;- të ndërtojë me shkrim harta³ të teksteve të ndryshme;- të shkruajë përmbledhje analitike të teksteve të ndryshme;- të shkruajë lloje të ndryshme tekstesh, të cilat:<ul style="list-style-type: none">▪ zhvillojnë një ide,▪ kanë një organizim strukturor të përshtatshëm me qëllimin, audiencën dhe kontekstin,▪ përfshijnë informacione të rëndësishme, duke përfshirë informacionet më pak të rëndësishme,▪ bëjnë përmbledhje me një rrjedhë logjike,▪ mbështesin gjykimet me të dhëna të përshtatshme e thelbësore si dhe me detaje të përzgjedhura,▪ paraqesin përfundime koherente.- të zbatojë të gjitha ligjet e të drejtës së autorit/autoreve ndaj informacionit të përdorur në punët me shkrim;- të përdorë efektivisht stilin vetjak për të mbështetur qëllimin dhe për të përfshirë audiencën në shkrimin e tij.

³ Harta kërkon që nxënësi të shpjegojë logjikën e brendshme të një teksti. Cilat janë pjesët përbërëse të një teksti? Si kontribuon secila pjesë tek e tëra? Harta skicon në mënyrë kronologjike tekstin dhe tregon sesi funksionojnë në të detajet dhe shembujt mbështetës.

Linja: Drejtshkrimi dhe pikësimi

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e rregullave drejtshkrimore, të pikësimit dhe të njohurive të gjuhës standarde shqipe. Ai/ajo i përdori këto njohuri në shkrimet e tij si dhe në procesin e redaktimit. Nxënës/i,-ja përdori materiale të ndryshme burimore që e ndihmojnë gjatë procesit.

Linja	Objektiva
Drejtshkrimi dhe Pikësimi	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none">- të përdorë rregullat drejtshkrimore të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj;- të përdorë njohuri të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të të tjerëve;- të përdorë rregullat e pikësimit të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj;- të përdorë njohuri të pikësimit të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të të tjerëve;- të përdorë një shumëllojshmëri materialesh burimore të tilla, si: fjalor shpjegues, enciklopedik, termash, libër gramatike, internet etj., për të qortuar punët me shkrim.

TË FOLURIT

Linja: Diskutimi

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë për të marrë role të ndryshme në një diskutim. Ai/ajo mbështet a kundërshton një pozicion të caktuar; vlerëson rolin e qëllimit, audiencës, situatës dhe kontekstit në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi.

Linja	Objektiva
Diskutimi	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none">- të mbajë një qëndrim të caktuar ndaj një diskutimi në grup;- të dallojë rolet e ndryshme në një diskutim: rolin e moderatorit, rolin e drejtuesit, rolin e dëgjuesit etj.;- të mbështesë një pozicion në diskutimet që realizohen në grupe të vogla ose të mëdha;- të paraqesë alternativën personale mbi çështjen a tekstin e caktuar;- të respektojë kërkesën për një përmbajtje të ngjeshur duke respektuar faktorin kohë;- të përmbledhë përfundimet e një diskutimi;- të shprehë një mesazh koherent;- të marrë parasysh rolin e qëllimit, e audiencës, e situatës

	<p>dhe kontekstit në një diskutim;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shfrytëzojë pasurinë leksikore e semantike për të shprehur saktë mendimet e tij/saj në diskutime në grupe të vogla e të mëdha.
--	--

Linja: Hetimi dhe kontributi

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë për të hetuar informacionin dhe për të kontribuar në diskutime që bëhen në grupe të vogla dhe të mëdha. Ai/ajo bën pyetje dhe i përgjigjet audiencës, merr pjesë aktive në diskutim, parafrazon komente të prezantuara me gojë dhe merr parasysh elementet e gjuhës së gjesteve në një prezantim. Për të hetuar e kontribuar në diskutime, nxënës/i,-ja ushtrohet në veprimtari praktike për tema të fushave të ndryshme.

Linja	Objektiva
Hetimi dhe kontributi	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë pyetjet e duhura, kur diskutohen tema të ndryshme; - të zgjedhë pjesë letrare për të zbuluar tema të ndryshme; - të diskutojë pjesë letrare për të zbuluar tema të ndryshme; - t'u përgjigjet pyetjeve të audiencës duke dhënë sqarime dhe ilustrime; - të marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutime të llojeve të ndryshme për të ndarë me të tjerët mendimet e tij/e saj; - të zgjedhë pjesë letrare për të trajtuar tema të ndryshme; - të parafranojë komente të prezantuara me gojë nga të tjerët, për të sqaruar këndvështrimin e tyre; - të zbatojë udhëzime të ndryshme, për të kryer detyra specifike, për t'u përgjigjur pyetjeve ose për të zgjidhur probleme; - të identifikojë faktorët (organizimi, stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajtja, këndvështrimi etj.) që ndikojnë në kompozimin e mesazhit të tij/të saj; - të përdorë elemente të gjuhës së gjesteve, të domosdoshme për të prezantuar mesazhin; - të marrë parasysh rolin e vlerësimit në komunikimin gojor.

Linja: Zgjedhja e fjalëve

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë e përzgjedhjes së fjalëve të përshtatshme për të sqaruar idetë në një komunikim gojor.

Linja	Objektiva
Zgjedhja e fjalëve	Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :

	<ul style="list-style-type: none"> - të zgjedhë fjalët e duhura për të ruajtur tonin e përshtatshëm në diskutime e prezantime me gojë; - të zgjedhë fjalët e duhura për të shprehur idetë në diskutime e prezantime me gojë.
--	--

Linja: Prezantimi me gojë

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë e domosdoshme për të realizuar një prezantim gojor. Ai/ajo përdori strategjitë efektive për të përcjellë një mesazh gojor duke respektuar faktorin kohë. Nxënës/i,-ja redaktonte drafte (skicime/hartime) të fjalimeve dhe përpunoi prezantimin gojor për të orientuar audiencën.

Linja	Objektiva
Prezantimi me gojë	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të prezantojë në mënyrë individuale ide kryesore të një pune me shkrim; - të prezantojë në mënyrë individuale për një çështje gramatikore; - të prezantojë në mënyrë individuale për një çështje/temë të caktuar nga mësues/i,-ja që lidhet me konceptet dhe temat e trajtuara në tekstet e lexuara; - të prezantojë në grup për një çështje/temë të caktuar nga mësues/i,-ja që lidhet me konceptet dhe temat e trajtuara në tekstet e lexuara; - të përdorë një shumëllojshmëri strategjish organizative (tabela, diagramë, grafikë, kllaster); - të demonstrojë strategji efektive të përcjelljes së mesazhit gojor (organizimi, gjuha e gjesteve, fjalor i përshtatshëm); - të respektojë faktorin kohë në prezantimet me gojë; - të përpunojë prezantimin gojor për të orientuar drejt audiencën.

TË DËGJUARIT

Linja: Të dëgjuarit e qëllimshëm

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë e domosdoshme për të dëgjuarit e qëllimshëm. Ai/ajo përqendrohet tek folësi, diskuton dhe zgjeron idetë e dëgjuara; mban shënime të tilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm. Për të realizuar këto, nxënës/i,-ja merr pjesë në veprimtari praktike, ku dëgjon për tema të fushave të ndryshme.

Linja	Objektiva
Të dëgjuarit e	Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :

qëllimshëm	<ul style="list-style-type: none"> - të përqendrojë vëmendjen në mënyrë të përgjegjshme mbi folësin ose mesazhin; - të diskutojë me gojë idetë e dëgjuara; - të zgjerojë me gojë idetë e dëgjuara; - të mbajë shënime të atilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm; - të bëjë pyetje të përshtatshme që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm; - të identifikojë fjalët e reja nëpërmjet kontekstit në komunikimet gojore; - të zbulojë kuptimin e fjalëve të reja nëpërmjet kontekstit në komunikimet gojore; - të tregojë si zgjedhja e fjalëve dhe e gjesteve zbulojnë qëllimin e folësit.
-------------------	---

Linja: Të dëgjuarit për të reflektuar

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja zotëron aftësitë për të reflektuar ndaj informacionit të dëgjuar. Ai/ajo përmbledh, parafrazon dhe vlerëson përmbajtjen e informacionit të dëgjuar, si dhe analizon mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose ligjërate mbështet a kundërshton domethënien ose qëllimin e saj. Nxënës/i,-ja reflekton mbi informacione të llojeve dhe fushave të ndryshme.

Linja	Objektiva
Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë përmbajtjen dhe mënyrën e prezantimit gojor; - të vlerësojë besueshmërinë e folësit; - të përcaktojë rastet kur përdoret propaganda apo argumenti në komunikimin gojor; - të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme në një debat; - të zbatojë përmbajtjen e një informacioni të dëgjuar; - të ndjekë udhëzime gojore për të kryer veprime të ndryshme; - të parafranojë informacionin e prezantuar me gojë nga të tjerët; - të përmbledhë informacionin e prezantuar me gojë nga të tjerët.

TË VËSHTRUARIT

Linja: Ndërtimi i domethënies/kuptimit nga forma të ndryshme mediatike

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e elementeve përbërëse të një mesazhi pamor dhe gojor. Ai/ajo i përdor këto njohuri për të identifikuar mesazhet e ndryshme mediatike si pjesë e realitetit social.

Linja	Objektiva
Ndërtimi i domethënies/kuptimit nga forma të ndryshme mediatike	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë mesazhet mediatike si përfaqësime të realiteteve sociale që ndryshojnë në periudha dhe vende të ndryshme; - të identifikojë si një produkt mediatik shpreh vlerën e kulturës që e prodhon; - të identifikojë format mediatike (reklama, dokumentari, fotografia, piktura, skulptura etj.), të përshtatshme për qëllimin e lexuesit; - të identifikojë fjalët, tingujt dhe imazhet si mjete shprehëse dhe elemente përbërëse të një mesazhi; - të analizojë aspekte të tekstit të shtypur dhe elektronik që mbështesin këndvështrimin, qëndrimin ose opinionin e autorit; - të shpjegojë përdorimin e fjalëve, tingujve e imazheve statike dhe të lëvizshme, në mesazhe të ndryshme mediatike, për qëllime të ndryshme; - të zbulojë anë të përbashkëta dhe dalluese për mënyrën si forma të ndryshme mediatike (gazeta, radioja, televizioni, interneti etj.) shtjellojnë tema të njëjta.

Linja: Mesazhet pamore dhe verbale

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi të kuptuarit e teknikave pamore në një mesazh mediatik. Ai/a jo identifikon stereotipet e ndryshme nëpërmjet këtyre teknikave, në format e ndryshme mediatike.

Linja	Objektiva
Mesazhet pamore dhe verbale	<p>Në përfundim të klasës së 10 nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë stereotipet gjinore, etnike etj. në forma të ndryshme mediatike; - të dallojë teknikat pamore (ngjyra, zmadhim/zvogëlimi, këndvështrimi, përzgjedhja e detajeve etj.) në mesazhe të ndryshme mediatike, të përdorura për një audiencë të caktuar; - të analizojë përparësitë dhe mangësitë e reklamimit pamor dhe gojor; - të vlerësojë besueshmërinë e përmbajtjes së mesazheve të ndryshme mediatike; - të krijojë rubrika vlerësimi për të gjykuar efektivitetin e mesazheve gojore dhe pamore; - të zbulojë nënkuptimet që fshihen pas imazheve statike grafike (fotografi, pikturë, skulpturë etj.).

Linja: Informimi nga mediat e ndryshme

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja demonstroi aftësitë e përdorimit të burimeve të ndryshme mediatike për t'u informuar për qëllime të caktuara. Ai/ajo identifikon format, teknikat dhe teknologjitë e përdorura në mesazhe, identifikon ndikimet politike, ekonomike e sociale dhe diskuton rreth tyre.

Linja	Objektiva
Informimi nga mediat e ndryshme	<p>Në përfundim të klasës së 10^{të} nxënës/i,-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë tekste të mediave të shtypura dhe elektronike për të zbuluar marrëdhëniet njerëzore, idetë dhe aspektet kulturore; - të identifikojë ndikimet politike, ekonomike dhe sociale në mesazhe të ndryshme mediatike; - të diskutojë për ndikimet politike, ekonomike dhe sociale në mesazhe të ndryshme mediatike; - të identifikojë format, teknikat dhe teknologjitë e përdorura në mesazhe dhe paraqitje të ndryshme mediatike; - të vlerësojë forma të ndryshme mediatike, si p.sh.: televizionin, videon, lojërat, muzikën dhe filmin për të kuptuar përshtatshmërinë e mesazhit duke marrë parasysh audiencën, qëllimin e kontekstin; - të analizojë përmbajtjen e mesazheve mediatike në lidhje me efektin emocional që ka tek vështruesi.

4. TABELA E KËRKESAVE TË GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjuha shqipe dhe letërsia	Matematika
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit Të vështruarit	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë tabela, grafikë dhe diagrame të thjeshta rrethore dhe në shtylla për të prezantuar dhe interpretuar informacione të ndryshme me shkrim dhe me gojë.
Gjuha shqipe dhe letërsia	Arti Pamor
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit Të vështruarit	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë karakteristikat e veprave të artit pamor në periudha të ndryshme kohore dhe kontekste të ndryshme kulturore; - të përdorë elementet dhe parimet e artit pamor për të shprehur emocionet e marra nga një tekst; - të zbulojë shenjat artistike.

Gjuha shqipe dhe letërsia	Gjuha e huaj
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit Të vështruarit	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë leksikun e gjuhës së huaj për të shpjeguar etimologjinë e fjalëve me prejardhje të huaj. - të përdorë leksikun e fjalëve të gjuhës shqipe për të shpjeguar kuptimin e fjalëve të huaja.
Gjuha shqipe dhe letërsia	Teknologji
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit Të vështruarit	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> - të shkruajë në Word tekste të llojeve të ndryshme; - përdor programin Power Point për të bërë prezantime të ndryshme; - të përdorë internetin për të nxjerrë informacione të ndryshme; - të ndërtojë tabela, grafikë, diagrame të thjeshta për të përpunuar e prezantuar informacione të ndryshme; - të përdorë mjete të ndryshme elektronike, si: kompjuter, magnetofon, diktofon, video për qëllime të ndryshme.
Gjuha shqipe dhe letërsia	Muzika
Të lexuarit Të shkruarit Të folurit Të dëgjuarit Të vështruarit	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë vepra të ndryshme muzikore të periudhave të ndryshme kohore; - të zbulojë vlerat e artit muzikor; - të vlerësojë efektet muzikore në një film a dokumentar, si mjete që ndihmojnë për të kuptuar domethënien e filmit a dokumentarit.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për t'u zbatuar në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare, ku bën pjesë edhe kjo lëndë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmenduara.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë u duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit.
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare.
- Vlerësimin të nxënësit me notë.
- Parimeve të mësimdhënie/mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë për klasën paraardhëse dhe klasat pasardhëse.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore e fetare.

Objektivat

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat.

P.sh.:Lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë

Objektivi: “Të shkruajë hyrje dhe mbyllje tërheqëse dhe koherente të një teksti”.

Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të ushtrohen në shkrimin e hyrjeve dhe mbylljeve tërheqëse dhe koherente. Nëse një mësues/e nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm.

Mësues/i,-ja dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh. Lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë

- Objektivi: “Të shkruajë lloje të ndryshme tekstesh, të cilat:
 - zhvillojnë një ide,
 - kanë një organizim strukturor të përshatshëm me qëllimin, audiencën dhe kontekstin,
 - përfshijnë informacionin e rëndësishëm duke përjashtuar informacionet më pak të rëndësishme,
 - bëjnë përmbledhje me një rrjedhë logjike,

- mbështesin gjykimet me evidencë të përshtatshme e thelbësore, si dhe me detaje të përzgjedhura,
- paraqesin konkluzione koherente.

Të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të ushtrohen në shkrimin e teksteve, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel realizimi.

Një nivel arritjeje është zbatimi i të gjithë hapave të domosdoshëm për shkrimin e një teksti. Një nivel më i lartë se ky është cilësia e trajtimit të secilit nga hapat e lartpërmendur. Nëse të gjithë hapat do të zhvilloheshin sipas kërkesave të mësuara, atëherë do të kishim përmbushjen e këtij objekti në një nivel të lartë.

Realizimi i objektivave në tema, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Objektivat e programit duhet të jenë të konkretizuar në tekste letrare dhe joletrare, të shkruara dhe jo të shkruara, të përshtatshme për moshën e nxënësit.

Gjatë vitit shkollor, nxënës/i,-ja është i detyruar të lexojë 3-5 libra (vepra letrare ose joletrare, të gjinive të ndryshme, shqiptare dhe të huaja, të periudhave të ndryshme), krahas pjesëve që janë në përbërje të tekstit të gjuhës shqipe.

Sqarime mbi llojet e teksteve

Në përmbajtjen e programit përdoren termat: tekst tregimtar, tekst poetik, tekst dramatik, tekst bindës/argumentues, tekst përshkruar, tekst shpjegues dhe tekst informativ, të cilët konkretisht do të nënkuptojnë:

- Tekstin tregimtar që tregon një ngjarje/histori të organizuar në prozë. Llojet e teksteve tregimtare mund të jenë imagjinare, të vërteta ose një kombinim i të dyjave, si p.sh.: tregime, fragmente romani, fragmente novele etj.
- Tekstin poetik që shpreh ndjenjat, mendimet, reflektimet etj. Llojet e teksteve poetike janë epike dhe lirike.
- Tekstin dramatik në tri format e realizimit të tij: tragjedi, komedi, dramë.
- Tekstin bindës/argumentues që prezanton një argument dhe e mbron ose e kundërshton atë me të dhëna bindëse. Llojet e teksteve bindëse/argumentuese mund të jenë të tipit ese.
- Tekstin përshkruar që përshkruan një person, vend, kujtim, përvojë a objekt. Llojet e teksteve përshkruese mund të jenë të tipit ese.
- Tekstin shpjegues që shpjegon dukuri, çështje a tema të ndryshme. Llojet e teksteve shpjeguese mund të jenë: ese, receta, artikuj, dokumente qeveritare etj.
- Tekstin informativ që prezanton të dhënat e nevojshme mbi një çështje a temë të caktuar. Llojet e teksteve informative mund të jenë: memorandume, shënime, letra të llojeve të ndryshme, raportime, manuale etj.

Në klasën e 10^{te} do të punohet me tekste përshkruese (ese), tekste shpjeguese (ese), tekste bindëse /argumentuese (ese), tekste informative (aplikime për punë e për shkollë, letër zyrtare), tekste tregimtare (tregime, fragmente romani/novele), tekste poetike dhe tekste dramatike që u përkasin drejtimeve të ndryshme letrare. Gjithashtu, do të punohet edhe me pjesë nga folklori dhe dokumente të ndryshme.

Pjesët duhet të jenë të përshtashme për moshën e nxënësve dhe të përfshijnë vepra të shquara të letërsisë shqiptare (60%) dhe botërore (40%).

Kritere për përzgjedhjen e fragmenteve dhe veprave të detyruara

- Fragmentet e përdorura në tekstin e nxënësit "Gjuhë shqipe dhe letërsi" duhet të realizohen në jo më pak se 3 orë (secila). Përveç kritereve të përzgjedhjes së fragmentit, ai duhet të përmbush objektiva të ndryshme për të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit.
- Përdoruesit e programit janë të lirë të zgjedhin nga lista rekomanduese. Pjesët e përzgjedhura duhet të trajtohen në tekstin e nxënësit duke respektuar parimin gjinor, si dhe duke filluar nga krijimtaria e periudhës më të hershme.
- Veprat e përzgjedhura si të detyruara për t'u trajtuar të plota duhet të realizohen në jo më pak se 6-7 orë secila. Edhe këto vepra, përveç kritereve të përzgjedhjes duhet të përmbushin objektiva të ndryshme për të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit.
- Përzgjedhja e veprave duhet të bëhet duke respektuar parimin gjinor, si dhe duke filluar nga krijimtaria e periudhës më të hershme. Ato nuk duhet t'i përkasin të njëjtës periudhë letrare.
- Është e detyrueshme që vepra e përzgjedhur të lexohet e plotë.
- Përdoruesit e programit duhet të pasqyrojnë në tekstin e nxënësit të gjitha veprimtaritë e domosdoshme për trajtimin e plotë të veprës.
- Tërësia e veprave dhe e fragmenteve të planifikuara në tekstin e nxënësit duhet të përmbushin të gjitha objektivat e programit.

Rekomandime

Për të përmbushur objektivat e lëndës, përdoruesit e programit mund të përzgjedhin vepra dhe pjesë nga autorët e mëposhtëm të letërsisë shqiptare dhe botërore, të periudhave të ndryshme.

Teksti poetik

Anonim "Epi i Gilgameshit"; Homeri "Iliada"; Virgjili "Eneida"; "Këngë të epikës legjendare shqiptare"; Lirika antike: Safo, Anakreonti, Katuli; Këngë lirike popullore; Dante Aligeri "Komedia hyjnore"; Petrarka "Sonete"; Pjetër Bogdani "Çeta e profeteve"; Pjetër Budi "Poezi"; Jeronim De Rada "Këngët e Milosaos"; Zef Serembe "Lirika"; J.V.Gëte "Balada" Bajron "Cajld Harold"; Naim Frashëri "Lulet e verës"; Ndre Mjeda "Andrra e jetës"; Asdreni "Lirika"; Gjergj Fishta "Lirika atdhetare"; A Z Cajupi "Baba Tomorri"; Fan Noli "Album"; Lasgush Poradeci "Lirika"; Migjeni "Vargjet e lira"; F. G. Lorka "Poezi"; Mihail Eminesku "Poezi" Rajner Maria Rilke "Lirika" Esad Mekuli "Për ty"; Dritëro Agolli "Lirika"; Ismail Kadare "Lirika"; Martin Camaj "Poezi"; Ali Podrimja "Torzo"; Azem Shkreli "Lirika"; Xhevahir Spahiu "Poezi"; Apoliner "Poezi"; Bodler "Lulet e së keqes".

Teksti tregimtar

“Mitologji greke”; Përralla popullore shqiptare; Marin Barleti “Historia e Skënderbeut”; Gjon Buzuku “Parathënia” e “Mesharit”; Miguel Servantes “Don Kishoti”; Çarls Dikens “David Koperfild”; Viktor Hygo “Të mjerët”; Stendal “Novela”; Honore de Balzak “Evgjeni Grande”; Anton Cehov “ Një shaka e vogël”; Lev Tolstoi “Novela”; Fan Noli “Histori e Skënderbeut”; Mitrush Kuteli “Nete shqiptare”; Ernest Koliqi “Nusja e mrekullueshme”; Migjeni “Novelat e Qytetit të Veriut”/skica; Viktor Hygo "Të mjerët"; Ernest Heminguej “Dëborat e Kilimanxharos”; Marsel Prust “Në kërkim të kohës së humbur” (fragmenti “Madlene”); Dritëro Agolli “Njerëz të krisur”; Ismail Kadare “Ura me tri harqe”; Ismail Kadare “ Kronikë në gur”; Ismail Kadare “Prilli i thyer”; Petro Marko “Nata e Ustikës”; Erih Maria Remark “Asgjë të re nga fronti i perëndimit”.

Teksti dramatik

Eskili “Orestia”; Eskili “Prometeu i mbërthyer”; Sofokliu “Antigona”; Aristofani “Bretkocat”; Rasini “Horaci”; Molier “Kopraci”; Molier “Tartufi”; Shekspir “Romeo dhe Zhuljeta”; Shekspir “Shumë zhurmë për asgjë”; F Shiler “Vilhelm Tel”; H Ibsen “Shtëpia e kukullës”; A Z Cajupi “14 vjeç dhëndër”; Gjergj Fishta “Juda Makabe”; F Noli “Izraelitë dhe filistinë”.

Teksti eseistik

Faik Konica, Fan Noli, Mithat Frasheri, Mitrush Kuteli, Branko Merxhani, Tahir Zavalani, Eqerem Cabej, Ismail Kadare, Folkner, Tomas Elliot, Roland Bart, Arshi Pipa, Aurel Plasari, Artan Fuga, Agim Vinca, Rexhep Qosja, Sabri Hamiti.

Lista nga do të përzgjidhen veprat e plota të detyruara:

- Epi i Gilgameshit; Homeri “Iliada”; Populli “Kënge të epikës legjendare shqiptare”; Naim Frasheri “Lulet e verës”; Jeronim de Rada “Këngët e Milosaos”; Bajron “Cajld Harold”.
- Eskili “Prometeu”; Shekspir “Romeo dhe Zhuljeta”; Shekspir “Nata e dymbëdhjete”; Molier “Mizantropi”.
- Miguel Servantes “Don Kishoti”; Marin Barleti “Historia e Skënderbeut”; Viktor Hygo “Katedralja e Parisit”; Pashko Vasa “ Bardha e Temalit”.

Përkthyes të njohur (sipas renditjes alfabetike):

Agron Tufa, Aurel Plasari, Dritëro Agolli, Edmond Tupja, Fan Noli, Gjon Shllaku, Ismail Kadare, Lasgush Poradeci, Mira Meksi, Misto Treska, Mitrush Kuteli, Pashko Gjeçi, Pavli Qesku, Robert Shvarc, Sotir Caci, Sotir Papakristo, Tahir Zavalani, Vedat Kokona etj.

Dokumente

Dokumente (p.sh.: Deklarata e Pavarësisë së Kosovës etj.) ligjërime e fjalime historike e politike të rëndësishme, të figurave të shquara shqiptare dhe të huaja.

Për të realizuar objektivat lëndore (p.sh: për tekste informative, tekste jo të shkruara etj.) është e nevojshme që përdoruesit të shfrytëzojnë vepra dhe punime të autorëve të tjerë, të cilat ua mundësojnë këtë.

Pesha specifike sipas llojit të tekstit (të lexuarit)

Teksti tregimtar	15%
Teksti poetik	20%
Teksti dramatik	10%
Teksti bindës/argumentues	15%
Teksti përshkrues	15%
Teksti shpjegues	15%
Teksti informativ	10%

Punët me shkrim që duhet të realizojë nxënës/i,-ja i klasës së 10^{të} (të shkruarit)

Punët me shkrim duhet të vlerësohen për të gjithat hapat e procesit të të shkruarit (Hapat janë të detajuara tek objektivat e linjave).

Parafrazim dhe përmbledhje
Përmbledhje analitike
Harta e tekstit
Ese përshkruese mbi një produkt mediatik
Ripunim i esesë përshkruese
Ese shpjeguese
Tekst informativ
Ese bindëse/argumentuese
Ripunim i esesë bindëse/argumentuese

Produktet që duhet të vështrojë nxënës/i,-ja i klasës së 10^{të} (të vështruarit)

Reklama
Fotografi
Piktura
Skulptura

Prezantimet me gojë që duhet të realizojë nxënës/i,-ja i klasës së 10^{të} (të folurit)

- Dy prezantime individuale të ideve kryesore të një pune me shkrim.
- Prezantim individual për një çështje të caktuar gjuhësore ose koncept letrar (e përcaktuar nga mësues/i,-ja ose e përzgjedhur nga nxënës/i,-ja).
- Prezantim individual për një çështje të caktuar nga mësues/i,-ja që lidhet me konceptet dhe temat e trajtuara në tekstet e lexuara.
- Dy prezantime në grup për çështje të caktuara nga mësues/i,-ja që lidhen me konceptet dhe temat e trajtuara në tekstet e lexuara.

Orët mësimore

Programi i gjuhës shqipe dhe letërsisë për klasën e 10^{të} është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia/mësimnxënia do të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor. Është e rëndësishme të theksojmë se brenda një ore mësimi duhet të realizohen: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit, të vështruarit, pra, ***nxënës/i,-ja do të ushtrohet për të pesë aftësitë brenda orës së mësimi***, pavarësisht se cila linjë do të ketë *pesë specifike* më të madhe.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës dhe janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësues/i,-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij/e saj hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të veçanta, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij/e saj demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë afërsisht 70% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 30% e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen e njohurive bazë (konceptet themelore).
- Testimin e njohurive bazë.
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë paraardhëse.
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme).
- Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si një e tërë).
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme, si: komunikimit, përpunimit të informacionit, zgjidhjeve problemore e të menduarit kritik dhe krijues.
- Aftësive të posaçme lëndore, si: strategjive të të lexuarit, procesit të shkrimit, zhvillimit të të dëgjuarit aktiv, të vështruarit analitik, strategjive të të folurit në diskutime në grup dhe prezantime individuale me gojë.
- Formimit të qëndrimeve, si: qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi.

Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Kritere specifike për vlerësimin në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë

- Mësues/i,-ja mund ta vlerësojë nxënësin për aftësitë e të folurit dhe të të shkruarit për një larmishmëri audiencash dhe qëllimesh nëpërmjet disa mënyrash, si:
 - Ditari mësimor i nxënës/it,-es: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të qartësojë mendimet e të përgatitet për diskutimin në klasë, të zbatojë efektivisht elemente të procesit të shkrimit dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë përdorimin efektiv të gjuhës, si dhe qëndrimet e nxënësve.
 - Diskutimi mbi një film/dokumentar: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të kuptojë përmbajtjen e të zgjerojë mendimet dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë analitike e gojore të nxënësit, si dhe mënyrën e aplikimit të njohurive në jetën e përditshme.
 - Prezantimi me gojë: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të lexojë në mënyrë efektive dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë sesi ai sintetizon materialin e një teksti.
 - Shkrimi i esesë përshkruese: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të qartësojë mendimet e të përdorë efektivisht elementet e procesit të shkrimit dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij shkruese.
- Vlerësimin e aftësive për të lexuar, për të dëgjuar dhe për të vështruar materiale të formave të ndryshme mediatike, mësues/i,-ja mund ta bëjë duke përdorur mënyra të tilla, si:
 - Lexim dhe diskutim në grup i një fragmenti: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të zhvillojë strategjitë e të lexuarit e të reflektojë ndaj tekstit. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë strategjitë e të lexuarit dhe aftësitë reflektuese.
 - Shikim dhe diskutim në grup i një filmi/dokumentari: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të kuptojë përmbajtjen e të zgjerojë mendimet

dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë analitike dhe gojore të nxënësit, si dhe mënyrën e aplikimit të njohurive në jetën e përditshme.

- Vlerësimin e aftësive për të përzgjedhur përmes strategjive të ndryshme, për të kompletuar projekte individuale dhe në grup, mësues/i,-ja mund ta bëjë duke përdorur mënyra të tilla, si:
 - Krijimi i rubrikës së vlerësimit: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të mendojë në mënyrë analitike e të njohë mirë standardet për realizimin e projekteve. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij analitike, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen mbi standardet e kompletimit të një projekti.
 - Përcaktimi i temës së projektit: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të bëjë zgjedhje të kuptimshme dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë dhe arsyet e tij përzgjedhëse.
- Vlerësimin e aftësive për të reflektuar mbi tekstin dhe për të mbajtur qëndrime, mësues/i,-ja mund ta bëjë duke të përdorur mënyra të tilla, si:
 - Shkrimi i esesë argumentuese: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të përdorë argumentet e të bëjë kërkime për të mbrojtur argumentet e tij. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij logjikuëse dhe përdorimin e informacionit të marrë nga tekstet e lexuara.
 - Debati mbi një temë të caktuar: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të ndërtojë dhe mbrojë qëndrimet e tij me gojë. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij, për të parashtruar mendimin dhe për ta mbrojtur atë.
 - Diskutimi në grup mbi qëllimin e autorit/autore: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të punojë me tekstin për të përcaktuar qëllimin e autorit/autore dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë mendimin e tij analitik, si edhe të dëgjuarit aktiv.
 - Shkrimi i një letre zyrtare: kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të mbajë qëndrim mbi një çështje të mprehtë sociale, të vlerësojë informacione të marra nga burime të ndryshme dhe t'i sintetizojë ato në një letër drejtuar një institucioni. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e nxënësve për të gjykuar vlefshmërinë, objektivitetin, cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit që ai lexon, dëgjon dhe vështron.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/e saj me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarish a produktesh të tjera, si: shkruan, lexon, vlerëson, zbaton, analizon etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja duhet ta vlerësojë nxënësin jo vetëm për produktin përfundimtar, por për të gjitha hapat e procesit të të shkruarit.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësues/i,-ja vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënësit, tek ato një orëshe; teste me alternativa ose zhvillim, ese të llojeve të ndryshme, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënës/it,-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, ese tematike, projekte kurrikulare, ese të llojeve të ndryshme etj. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësues/i,-ja, nxënësi vetë dhe prindërit e tij/e saj gjejnë informacion të shpejtë dhe të përmbledhur rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh.: të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësues/i,-ja duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.